

FINAL DRAFT VERSION

**RREGULLORJA
PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE (MU)**

Bashkia Permet



Tabela e përmbajtjes

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI MENAXHIMIN E MNU	2
II. ROLI I BASHKISË NË MENAXHIMIN E MNU	7
III. ROLI I SEKTORIT TE PASTRIM-GJELBERIMIT NË MENAXHIMIN E MNU.....	10
IV. ROLI I BIZNESEVE DHE KOMUNITETIT NË MENAXHIMIN E MNU	15
V. TARIFA PËR MENAXHIMIN E MNU	17
VI. INFORMIMI I PUBLIKUT PER MENAXHIMIN E MNU.....	17
VII. NDALIMET DHE KONTROLLI	19
VIII. SANKSIONET PER SHKELJEN E RREGULLORES	20

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI MENAXHIMIN E MU

Neni 1 QËLLIMI

Kjo rregullore synon të krijojë një mjedis të favorshëm për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve duke:

Përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktortëve që janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane,

Analizuar të gjithë elementet teknik të sistemit (grumbullimi, fshirja, larja, transporti, reduktimi, riciklimi, kompostimi dhe trajtimi)

Siguruar një monitorim periodik në procesin e zbatimit të tyre.

Siguruar një menaxhim sa më eficient të mbetjeve urbane dhe standartizimin e shërbimit të pastrimit në Bashkinë Permet.

Neni 2 OBJEKTI I RREGULLORES

Fokusi i kësaj rregullore është krijimi i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e qytetit të Permetit duke përcaktuar rregullat specifike, teknikave më të mira të vlefshme dhe mënyrat e menaxhimit mjedisor të qendrueshëm të mbetjeve të ngurta urbane në çdo fazë të menaxhimit të tyre, që nga prodhimi deri në fazën finale të trajtimit të mbetjeve.

Më konkretisht kjo rregullore përfshin:

Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;

Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;

Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;

Marrjen e masave parandaluese për mosdjegjen e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;

Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;

Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve):

Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave në rast se shërbimi i menaxhimit të mbetjeve do të realizohet me kontrata private;

Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
Parandalimi i problemeve për shëndetin publik

Neni 3 **BAZA LIGJORE**

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar me ligjin Nr. 38/2019
Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013
Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” amenduar me ligjin nr. 53/2020 datë 30.4.2020
Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”
Vendim Nr. 660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”
Vendim Nr. 608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.
VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura
VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
VKM nr.117, datë 13/02/21013 "Për kriteret në bazë të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"
VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeteve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Neni 4 **AKTORET**

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

Bashkia Permet me departamentet përkatëse të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;

Të gjithë banorë të qytetit dhe njësisive administrative të Bashkisë Permet, kalimtarë të rastësishëm, turistë dhe pushues, shtetas të huaj resident në qytet, punonjës në organe e organizma publike e private;

Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike;

Personat juridike e fizike, publike dhe private, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të licensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjесimin e mbeturinave.

Neni 5 PERCAKTIMI I TERMAVE

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

“**Menaxhim i integruar i mbetjeve**” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtej

“**Mbetje e ngurtë**” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit

“**Mbetje bio**” janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, katering-u dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

“**Mbetje shtëpiake**” janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.

“**Mbetje inerte**” janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.

“**Mbetje e lëngshme**” është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat

“**Mbetje të rrezikshme**” janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

“**Vajra të përdorura**” janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.

“**Mbetje të vëllimshme**” janë mbetje me përmasa të mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave kryhet me metoda e teknika të veçanta; përfshihen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si: elektroshtëpiake, pajisjet informatike, mobilje, pjesë autoveturash, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre;

“**Grumbullim**” është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

“**Grumbullim me kontenierë**” është operacioni i largimit të mbetjeve në pika grumbullimi fikse, paraprakisht të përcaktuara nga Bashkia, jashtë vendeve të prodhimit të mbetjeve, ku prodhuesi dorëzon direkt mbetjet;

“**Grumbullim i diferencuar**” është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.

“**Ndarje e mbetjeve në burim**” është ndarja e mbetjeve urbane në fraksione të ndryshme sipas përbërjes merceologjike të tyre për të lejuar rikuperimin dhe/ose ripërdorimin;

“**Transportim**” është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.

“**Trajtim**” janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

“**Lendfill**” është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:

- një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;
- një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të: impianteve ku mbetjet shkarkohen për t’u përgatitur për t’u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër; vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;
- vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

“**Parandalim**” janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre; b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut; c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

“**Rikuperim**” është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që: a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdroshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar; b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.

“**Ripërdorim**” është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.

“**Riciklim**” është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.

“**Krijues i mbetjeve**” është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

“**Vend-ndodhja e mbetjeve**” është vendi ku ndodhet lendfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.

“**Operator i shërbimit**” është shoqëria/ndërmarrja, të cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, bashkia i beson dhe/ose lejon administrimin e mbetjeve të ngurta;

“**Pastrimi i rrugëve**” është shërbimi publik manual ose i mekanizuar i heqjes së mbetjeve të rëna në rrugë apo hapësira publike, duke përfshirë këtu parqe dhe hapësira të gjelbërta, ose rrugë dhe hapësira private objekt i përdorimit publik;

Pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane (PGM) janë sipërfaqe të vogla, që shërbejnë për dorëzimin e mbetjeve nga prodhuesit e tyre në kazanë.

“Zonë e kontratës” quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj konsumatorëve ekzitues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështërjes së kontratës brenda të njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.

Neni 6 PROCESI I MENAXHIMITTE MU

Procesi imenaxhimit të MNU synon që:

Të parandalohet çdo dëm ose rrezik për shëndetin dhe ndotja e mjedisit nga mbetjet e ngurta urbane dhe të reduktohet ndikimi kur ai ndodh;

Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve;

Në të gjitha fazat e menaxhimit prioritet do të jete grumbullimi i vecuar dhe mos përzjerja e mbetjeve të rrezikshme me mbetjet e ngurta urbane;

Ne promovimin dhe stimulimin e të gjitha veprimtarite prodhuese që rezultojnë me më pak mbetje;

Në realizimin e një cikël sa më të shkurtër për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;

Në reduktimin sa më shumë të jete e mundur të lëvizjes dhe transportit të mbetjeve dhe asgjësimit të tyre të kryhet në impiantin më të afërt;

Ne mbulimin e territorit me shërbimin e grumbullimit dhe transportin e sigurt të mbetjeve drejt impianteve të trajtimit, Mbetjet duhet të trajtohen sipas hierarkisë së mbetjeve duke ju nënshtruar sa më shumë teknikave të reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe përpunimit;

Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizikë dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve;

Të garantohen kërkesat higjieniko- shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjedisve urbane;

Neni 7 FAZAT E MENAXHIMIT TE MU

Proçesi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga prodhuesi i mbetjeve, dorëzimin sistematik në pikat e perkohshme të grumbullimit (PPG), largimin nga PPG për në landfill, vend-depozitim reduktimin riperdorimin, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe groposjen përfundimtare.

Neni 8 MBETJET OBJEKT I RREGULLORES

Në funksion të kësaj rregulloreje mbetjet urbane ndahen në kategoritë e mëposhtme:

1. Mbetje të ngurta urbane ku bëjnë pjesë mbetjet shtëpiake, të cilat janë kryesisht të riciklueshme dhe të dekompozueshme;
2. Mbetje të ngurta urbane të veçanta ku bëjnë pjesë mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet, mbetjet voluminoze, pajisje elektrike dhe elektronike, baterite dhe akumulatoret, vajrat e përdorur etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
3. Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të perkohshëm sipas burimit të prodhimit mbetjet e ngurta urbane klasifikohen në tre rryma:
4. Mbetjet e prodhuara nga familjet
5. Mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, përbërja e të cilave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve të ngurta urbane
6. Mbetjet e prodhuara nga institucionet

Neni 9

SISTEMI I MENAXHIMIT TE MU NE BASHKINE PERMET

Forma e ofrimit të shërbimit në bashkinë Permet është me shërbim publik nepermjet sektorit të pastrim-gjelberimit në Bashki.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve realizohet sipas grafikeve të përcaktuara nga bashkia në zonat e qytetit ose në njësitë administrative të bashkisë.

Bashkia monitoron në baze të specifikimeve teknike të përcaktuara në detyrat e sektorit të pastrim-gjelberimit të gjitha shërbimet e realizuara nga ky sektor dhe raporton çdo ditë përmbushjen sasiore dhe cilësore të tyre.

Bashkia raporton në mënyrë periodike, brenda datës 31 Janar të çdo viti, të dhënat për grumbullimin e rrymave të mbetjeve dhe objektivat në Agjensinë Kombëtare të Mjedisit.

II. ROLI I BASHKISË NË MENAXHIMIN E MU

Neni 10

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SHËRBIMIT NË BASHKI

Bashkia Permet ka përgjegjësi direkte në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, neni 33 pika 1, në mënyrë të veçantë në "grumbullimin, transportimin, asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve ngurta urbane" përcaktuar si një funksion i bashkisë.

Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi për:

- Organizimin për ofrimin i shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit të mbetjeve;
- Vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave;

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjive (rregullore, plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (Ligji 9537).

Policia e bashkiakë është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Kompanitë private (në rast të kryerjes së shërbimit privat) ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratën e nëshkruar me Bashkinë.

Njësitë administrative të Bashkisë Permet .Inspektorët përkatës monitorojnë ofrimin e shërbimit dhe raportin tek monitoruesit i njësisë të monitorimit të shërbimeve publike të zonave të caktuara sipas kontratës përkatëse.

Monitoruesit e njësisë të monitorimit të shërbimeve publike zbatojnë procedurën standarte të veprimit (PSV) duke informuar përgjegjës të njësisë dhe plotësuar formatet përkatëse. Ndërkohë ata janë të përfshirë në çdo kohë të monitorojnë pastrimin e qytetit dhe të verifikojnë procesin e monitorimit – raportimit nga ana e monitoruesve të njësisë dhe lagjeve të Bashkisë Permet sipas zonave përkatëse .

Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistin e sektorit, nën varësi të Drejtorisë së planifikimit të territorit dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës, koordinojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve që nga hartimi i preventivave për kontratat (në rast të kryerjes së shërbimit nga operatorë privat), evidentimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës dhe

hartimin e raporteve përfundimtare të gjendjes së shërbimit. Përgjegjësi i sektorit është personi kryesor në menaxhimin e sistemit, jo vetëm për Nj.A. Permet por edhe për njësitë e tjera, ku të gjithë administratorët raportojnë tek përgjegjësi në lidhje me situatën e ofrimit të shërbimit në territorin e tyre. Përgjegjësi i sektorit raporton tek Drejtori i planifikimit të territorit për situatën e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë, i cili më pas raporton në instancat vendim-marrëse të bashkisë (zv.Kryetari dhe Kryetari).

Bashkia në vend-depozitim të Pikovës cakton një person, i cili kryen raportime të rregullta mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në landfill nga i gjithë territori i Bashkisë.

Neni 11 **ORGANIZIMI I SHËRBIMIT**

Shërbimi në Bashkinë Permet organizohet nga sektori i pastrim-gjelberimit

Bashkia harton specifikimet teknike për shërbimin e pastrimit për tre zona të percaktuara nga vetë bashkia: (i) zona veriore ku bëjnë pjesë NJA-ve; Piskove, Frasher (ii) zona jugore ku bëjnë pjesë NJA-ve; Petran, Çarshove dhe (iii) zona qendrore ku bëjnë pjesë qyteti Permet.

Ndarja e shërbimit në disa zona bëhet për efekt të optimizimit të kostove, të bazuar mbi proceset e planifikimit të realizuara nga Bashkia dhe jo domosdoshmërisht është e lidhur me numrin e kompanive private që do të operojnë në terren.

Neni 12 **GRUMBULLIMI I MU**

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj me një standart sa më të lartë. Në këtë shërbim do të përfshihet grumbullimi i mbetjeve të ngurta urbane nga familjet, bizneset dhe institucionet, në të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve të percaktuara nga Bashkia në çdo njësi administrative.

Pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) janë sipërfaqe të vogla, që shërbejnë për dorezimin e mbetjeve nga prodhuesit e tyre. PGM-të duhet të kenë si bazament një sipërfaqe të rrafshët të betonuar ose të asfaltuar.

Bashkia miraton dhe publikon skemën aktuale të vend-ndodhjes së PGM si dhe strukturën, përmasat dhe numrin e konteniereve në secilën PGM. Ndryshimi i vendodhjes së PGM-ve, pa miratim të Përgjegjësit të shërbimit, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane mund të realizohet edhe në mënyrë të diferencuar (infrastruktura grumbulluese organizohet mbi numrin e rrymave specifike që grumbullohen në mënyrë të vecuar) ose i miksuar. Përcaktimi i metodës së grumbullimit të mbetjeve realizohet nga bashkia.

Prodhuesit e mbetjeve, gjithashtu mund të depozitojnë mbetjet e ngurta urbane, që janë subjekt i kësaj rregulloreje, në mënyrë individuale direkt në vend-depozitim në Piskove, në përputhje me këtë rregullore.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në periudhën e sezonit turistik Maj-Tetor do të realizohet dy here në ditë. Në periudhën e tjetër shërbimi i grumbullimit dhe transportit do të realizohet një here në ditë, kjo mund të ndryshojë në raport me masën e grumbullimit të mbetjeve.

Neni 13 **MONITORIMI DHE RAPORTIMI I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT**

Monitorimi dhe raportimi sigurojnë kontrollin e zbatimit referuar elementeve bazë të shërbimit të pastrimit që Bashkia Permet realizon me sektorin e pastrim-gjelberimit dhe si e tillë ajo fokusohet vetëm në monitorimin dhe raportimin e atyre shërbimeve/punëve, të cilat janë të percaktuara në aktivitetin e këtij sektori.

Monitorimi dhe raportimi realizohet çdo ditë nga inspektorët e pastrim-gjelberimit, Përgjegjësi i këtij sektori dhe personeli ngarkuar në NJA, për shërbimet sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kryerjes së këtij shërbimi.

Monitorimi i shërbimit të pastrimit realizohet duke verifikuar në çdo pikë vend-grumbullimi të mbetjeve, për çdo konteiner në qytet dhe në Njësi Administrative. Detyra e monitorimit të shërbimit përfshin monitorimin dhe raportimin për evadimin e mbetjeve, fshirjen ose larjen e rrugëve mirëmbajtjen e rrugëve, dhe menaxhimin e kontenierëve, çdo situatë tjetër, si psh. dëmtim kontenieri, djegie kontenieri etj.

Drejtoria e Planifikimit apo personeli ngarkuar i sektorit, çdo ditë, përfshirë të shtunë dhe të djelë, verifikojnë dhe raportojnë sipas zonës së mbulimit dhe sipas frekuencës, shërbimin e kryer të pastrimit në qytet. Shënojnë të dhënat e monitorimit sipas formateve të raportimit;

Administratorët dhe personeli i ngarkuar nga ana e tyre, çdo ditë, përfshirë të shtunë dhe të djelë, verifikojnë dhe raportojnë, sipas zonës së mbulimit dhe sipas frekuencës, shërbimin e kryer të pastrimit në NJA. Shënojnë të dhënat e monitorimit sipas formateve të raportimit;

Administratorët e njësive administrative, plotësojnë formularët, i firmosin dhe i protokollojnë ato në Njësinë Administrative dhe i dërgojnë me email, në adresën sherbimetpublike@bashkiapermet.gov.al, raportimet e plotësuara, të firmosura dhe të vulosura nga ana e administratorit. Njësia e monitorimit të shërbimit i printon dhe i regjistron pranë zyrës së protokoll arkivës. Raporti i ditës së shtunë dhe të djelë dërgohet me email së bashku me raportin e ditës së hënë. Sektori i Protokoll Arkivës regjistron çdo raportim të dorëzuar nga inspektorët e lagjeve, nga njësia e monitorimit, nga evidencieri i njësisë së monitorimit përgjegjës për monitorimin pranë landfillit, duke regjistruar praktikën në librin e protokollit, duke shënuar numrin, datën, orën e dorëzimit të dokumentit.

Specialistët/Monitoruesit e NJMSHP ndërkohë monitorojnë në mënyrë selektive shërbimin sipas një plani të paracaktuar një ditë më parë nga përgjegjësi/sja i njësisë të monitorimit të shërbimeve publike. Ata raportojnë shërbimin e kryer pas monitorimit të frekuencës të parë për qytetin Permet, në intervalin kohor ora 8:30 deri në ora 10:30.

NJMSHP pasi merr raportimin, evidenton shënimet e inspektorëve të lagjeve dhe të Njësive Administrative për punë të pakryer, shqyrton edhe informacionin e monitoruesve të njësisë, harton njoftimin me shkrim dhe njofton (me email) menjëherë përgjegjës të sektorit të pastrim-gjelberimit ose operatorin që ka kontratën e shërbimit, për punën e pakryer dhe penalitetet që rrjedhin:

DSHPNII i dërgon me email sektorit të shërbimit dhe Kryetarit/es të Bashkisë "Informacion mbi monitorimin e ofrimin e shërbimit të pastrimit për punë të kryer/pakryer për çdo zonë të shërbimit",

Përgjegjësi/sja i Sektorit të NJMSHP, sipas një plani kontrolli, sigurohet që njësia e monitorimit respekton procedurën standarte të monitorimit. Përgjegjësi/sja asiston dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave nga ana e specialistëve të njësisë së monitorimit. Përmes selektimit rastësor verifikon në terren punën e njësisë së monitorimit të shërbimit të pastrimit, dhe e raporton atë.

Neni 14

MONITORIMI DHE RAPORTIMI I DEPOZITIMIT TË MBETJEVE NË LANDFILL

Evidencieri i NJMSHP, kryen verifikimin e volumeve dhe pajiset me fletë peshoret përkatëse të mjeteve transportuese të mbetjeve urbane, që depozitojnë mbetje në vendepozitimin e perkoheshem ne Piskove. Ai shënon dhe mban kopje të faturave mbi peshimin.

Evidencieri i NJMSHP sipas çdo kontrate përditëson të dhënat, duke i regjistruar në evidencën format elektronik.

Evidencieri i NJMSHP harton dhe protokollon evidencën javore/mujore me të dhënat për mbetjet javore/mujore të depozituara në landfill sipas dokumentacionit justifikues (peshore, fature).

Neni 15

PROCEDURA E HARTIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËRMBLEDHËS PËR LIKUIDIM

NJMSHP bazuar në raportet ditore të përditësuara harton raportin përmbledhës mujor të penaliteteve për punë të pakryer sipas zonave dhe kontratave përkatëse. Raporti pranohet nga përgjegjësi i njësisë të monitorimit të shërbimeve publike dhe miratohet nga Drejtori i planifikimit të territorit.

Të gjitha procedurat për hartimin e dokumentacionit përmbledhës si: "Proces verbal për marrjen në dorëzim të shërbimit", "Proces-verbalin e konstatimit për punë të pa kryer", "Situacioni mujor për shërbimin e kryer kur shërbimi i pastrim-gjelberimit realizohet me kontraktor privat" etj janë të përcaktuara në procedurën standarte të veprimt (PSV) të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

III. ROLII SEKTORIT TE PASTRIM-GJELBERIMIT NË MENAXHIMIN E MU

Neni 16

GRUMBULLIMI I MU ME KONTENIERË

Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve kryhet në hapësirat publike bashkiake ose në oborret e shoqërive private apo publike dhe në përgjithësi në të gjitha vendet ku është parashikuar një prodhim i konsiderueshem mbetjesh urbane.

Kontenierët mund të vendosen brenda hapësirave private, brenda dyqaneve, tregjeve dhe pikave të shitjes me pakicë ose shumicë, apo brenda institucioneve publike, shkollave dhe qendrave sportive, etj me pëlqimin/ose jo të pronarit ose administratorit si dhe miratimin e Bashkisë.

Të gjithë kontenierët në cdo PGM duhet të jenë të pajisur me kapak, me shenja të dukshme të sigurisë gjatë natës.

Kontenierët me volum 1.1m^3 , plastikë ose metalik parashikohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në bashki.

Kontenierët plastikë apo metalik duhet të jenë me vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe me sistem rrotash të qëndrueshëm, me kapakë për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga impakti i faktorëve të jashtëm.

Prodhuësi i mbetjeve është i detyruar të përdorë kontenierin e disponueshëm, më të afërt. Në rastet kur kontenieri është i tejmbushur nga qeset, mbetjet duhet të dorëzohen në kontenierin tjetër disponibël dhe nuk duhet të lihen asnjëherë në tokë.

Konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh (zakonisht 1.1m^3) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve.

Neni 17

STANDARDI I GRUMBULLIMIT ME KONTENIERË

Spektori i pastrim-gjelberimit realizon grumbullimin e mbetjeve në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia sipas orareve dhe intererave të caktuara të shërbimit. Pasi të zbrasten të gjithë kontenierët e PGM, duhet të vendosen në vendin e duhur pa u dëmtuar gjatë lëvizjes, të mbyllet kapaku dhe vendi i PGM duhet të disinftktohet cdo here me solucione DDD.

Largimi publik i mbetjeve duhet të garantojë grumbullimin e të gjithë mbetjeve urbane që për çfarëdolloj motivi gjenden jashtë kontenierëve si edhe grumbullimin e mbetjeve urbanë që gjenden të shpërndara në hapësirat publike. Menjëherë mbas largimit të mbetjeve urbane territori përreth sheshit të kontenierëve pastrohet në një sipërfaqe 20-25 m^2 .

Standardi i shërbimit të grumbullimit do të konsiderohet i pranueshëm nga ana e grupit monitorues në qoftë se pas kryerjes së shërbimit në një rreze prej 5 m nga të gjitha anët e PGM nuk do të jetë presente asnjë papastërti.

Koha për zbrazjen e një kontenieri nuk duhet të jetë më shumë se 2 minuta për cdo kontenier në PGM. Në rast të ndonjë pengese në terren (parkime të paligjshme, trafik i papritur, mot jo i mirë etj) sektori i pastrim-gjelberimit apo operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre në një moment të dytë, kur ngjarjet penguese në terren të mos jenë më, por gjithnjë brenda orarit të përcaktuar për evadimin e kontenierëve.

Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierët e tejmbushur me mbetje të ngurta urbane, të pa transportuar dhe mbetje të ngurta urbane të lëna në zonën përreth kontenierëve ose në vendet e përcaktuara.

Cdo kontenier duhet të pastrohet dhe të lahet të paktën një herë në muaj. Bashkia përcakton në termat e referencës frekuencat e larjes së kontenierëve. Kjo frekuencë mund të jetë e ndryshme për tre zonat e ofrimit të shërbimit, sidomos për zonat turistike dhe ato urbane.

Neni 18

PLANIFIKIMI I KONTENIEREVE DHE VENDOSJA E TYRE

Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Bashkia. Kontenierët parashikohen në numër të tillë që të sigurojnë grumbullimin në kohë dhe në sasi, midis flukseve të çdo cikli dorëzimi. Cdo kontenier ka një numër për identifikimin e tij.

Gjatë operacionit të pastrimit të mbetjeve nga sektori publik i pastrim-gjelberimit apo zbatimit të kontratës, kompania/të private mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga bashkia. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kompania duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e kontenierëve.

Caktimi i PGM-ve, duhet bërë duke respektuar kriteret e higjenes, aty ku është e mundur në një distancë prej 10 metrash, largësi (vijë) ajrore nga dyert dhe dritaret e ndërtesave, në harmoni me infrastrukturën ekzistuese, për më tepër me qëllim lehtësimin e largimit publik të mbetjeve

Për të gjitha ndërtimet e reja, projektet e rikonstruksioneve apo zonave të reja urbane përcaktimi dhe miratimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve është i detyrueshem dhe bëhet në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues

Neni 19

MENAXHIMI I KONTENIEREVE

Kontenierët janë pronë e bashkisë dhe duhet të mirëmbahen dhe të zëvendësohen në rast dëmtimi nga kompania/të private apo qytetare. Bashkia duhet të kryejë këto shërbime mirëmbajtje për kontenierët: (i) lyerje, (ii) ndërrim rrotash, (iii) riparim kapaku dhe (iv) zëvendësim.

Bashkia duhet të zotërojë një rezerve kontenierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Bashkia duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e nevojshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një oficinë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme. Nevoja për konteniere të rinj është imediate pasi ata që janë aktualisht janë në numër shumë të vogël dhe të demtuar në raport me numrin e nevojshëm për të patur një shërbim të mirë në PGM

Kontenieret lahen dhe disinfektohen nga sektori i pastrim-gjelberimit apo kompania e pastrimit sipas përcaktimeve në kontratën e shërbimit.

Neni 20

TRANSPORTI I MBETJEVE

Transportimi publik i mbetjeve urbane për në vend-depozitimin e Piskoves bëhet nga sektori i shërbimit pranë Bashkisë. Operatorë private që kryejnë aktivitete pastrimi apo grumbullimi, transporti apo depozitimi mbetjesh, nuk ka Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane për qytetin dhe zonën historike do të kryhet gjatë turnit të nates për të evituar trafikun gjatë ditës. Në rastin e zonave rurale, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të MNU mund të kryhet edhe gjatë orëve të ditës.

Transportimi i MNU nga PGM për në vend-depozitimin e Piskoves bëhet me mjete teknologjike të posaçme dhe të mbuluara, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve urbane.

Në rastin e grumbullimit të diferencuar të fraksioneve të vecanta të MNU nuk mund të përdoret i njëjti mjet teknologjik që realizon edhe grumbullimin e miksuar të MNU.

Neni 21

STANDARDI I TRANSPORTIT TË MU

Bazuar në sasinë e mbetjeve të prodhuara, frekuencës së shërbimit, dhe eksperiencës në ofrimin të shërbimit në Bashkinë Permet, për territorin e saj Bashkia preferon mjete teknologjike me kapacitet deri në 10ton. Për rastin e zonës së apo

rrugicave të ngushta në qytet dhe në rrugët e ngushta të zonave rurale, rekomandohet përdorimi i mjeteve teknologjike deri në 5ton.

Te gjitha makinat teknologjike duhet të kenë të instaluar sistemin GPS për të realizuar monitorimin e lëvizjes së mjeteve teknologjike në zonat përkatëse, ndalesat e tyre në PGM, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenierëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

Mjetet teknologjike kur dalin nga vendepozitimi i perkoheshem apo kur hyjnë në rrugët e qytetit nga rrugë dytësore të paasfaltuara janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta llaçet, apo çdo papastërti tjetër që ndot qytetin.

Për ruajtjen higjieno-sanitare të punojësve të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve zbatohen normat në dispozicion për sigurinë dhe higjienën e punës. Punojësit duhet të jenë të pajisur me veshje të përshtatshme dhe me pajisje për mbrojtje personale, dhe duhet t'u nënshtrohen trajtimeve për kontrolle sanitare të parashikuara në ligj.

Neni 22

PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA E RRUGËVE

Qëllimi i këtij shërbimi është pastrimi (fshirja dhe mirëmbajtja) dhe larja e rrugëve me një cilësi sa më të lartë në qytetin Permet. Ky shërbim do të realizohet nga sektori i pastrim-gjelberimit apo kompania/të e kontraktuar për të kryer këtë shërbim. Në kontratë specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka bashkia për pastrimin, kontrollin për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për shkelje të kushteve e kërkesave të kontratës.

Shërbimi ndahet në: (i) fshirje manuale të rrugëve gjatë turnit të natës, (ii) fshirje mekanike e rrugëve gjatë turnit të ditës/natës dhe (iii) shërbimi për grumbullim mbeturinash gjatë ditës.

Këtij shërbimi i nënshtrohen të gjithë rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuarët kryesor të qytetit dhe të qendrës së banuar.

Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe i trajtimit special në përputhje me normat higjieno-sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.

Periodiciteti i shërbimit të pastrimit përcaktohet nga Bashkia sipas nivelit të ndotjes që shkaktohet.

Neni 23

FSHIRJA DHE LARJA MEKANIKE E RRUGËVE

Rrugët dhe sheshet kryesore fshihen mekanikisht dy herë në javë. Shërbimi kryhet gjatë turnit të natës nga ora 22.00 – 06:00

Fshirja mekanike realizohet nga një makinë fshesë, e cila përdoret për akset e lagjeve kryesore të qytetit. Gjithashtu është e nevojshme të realizohet fshirja mekanike e trotuareve dhe pedonale të qytetit duke përdorur një mjet më të vogël, ku makina fshesë nuk mund të hyjë.

Fshirja dhe larja e sipërfaqeve, të cilat nuk mund të aksesohen për shkak të parkimeve të mjeteve, do të rregullohet nga bashkëpunimi i sipërmarrësit me inspektoriatin rrugor mbi bazën e një grafiku të dakortësuar.

Numri i larjeve përcaktohet sipas sezonit dhe kushteve konkrete. Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen gjatë muajve Mars – Tetor sipas një grafiku të miratuar nga Drejtoria e Shërbimeve.

Për larjen përdoret uji me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 Ekoli për 100ml ujë. Në këto raste mund të përdoret edhe uji i puseve, lumenjve apo basenve të tjerë ujore.

Neni 24

FSHIRJA MANUALE E RRUGËVE

Fshirja manuale konsiston në largimin e hedhurinave, gjetheve, baltës dhe pluhurit nga rrugët trotuaret dhe sheshet e qytetit.

Mbetjet urbane që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve urbane sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.

Ndalohej kategorikisht dorëzimi i mbetjeve urbane që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e ujësjellësit, e ujërave të zeza, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferikë, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Frekuenca e fshirjes manuale është gjatë 7 ditëve të javës nga e hëna në të dielë gjatë turnit të natës, sipas grafikut të miratuar nga bashkia. Gjatë turnit të ditës do të bëhet mirëmbajtja e rrugëve.

Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje sigurie, si doreza, maska, kapele, rroba pune me shenja dalluese të kompanisë dhe shenja dalluese të sigurisë.

Me qëllim për të garantuar mbajtjen pastër të hapësirave publike mund të vendosen dhe të administrohen nën kujdesin e operatorit të shërbimit, koshat rrugore për mbetje urbane të dimensioneve të reduktuara të prodhuara nga kalimtarët.

Kalimtarët, mbetjet e çastit si ambalazhe të ndryshme i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Neni 25

PESHIMI I MBETJEVE URBANE

Të gjithë mbetjet e grumbulluara, përpara se të dorezohen apo dërgohen në proceset e rikuperimit apo përpunimit final, duhet të peshohen nëpërmjet përdorimit të një sistemi peshimi rregullisht të kolauduar.

Në vazhdim të operacionit të peshimit personi i ngarkuar apo autorizuar në vend-depozitim të Piskoves duhet të kryejë edhe rregjistrimet e të dhënave. Ai do të mbajë një regjistër të mjeteve që hyjnë, sasitë e mbetjeve që shkarkohen, lloji i mbetjeve dhe mjeti (njësia përkatëse), orët e shkarkimit të mbetjeve dhe do të raportojë në bashki.

Neni 26

RAPORTIMI PËR SHERBIMIN

Spektori i pastrimit gjelberimit apo kompania/te private duhet të mbajë të dhëna ditore në lidhje me elementet më poshtë dhe duhet t'i raportojë ato çdo muaj me shkrim tek drejtori i shërbimit:

Numri i zbrazjeve të kontenierëve në çdo rrugë;

Orët reale të grumbullimit: ora e nisjes të mjeteve, koha e shkarkimit në vend-depozitim, koha e kthimit në parkim e mjeteve;

Km ditorë të çdo mjeti;

Konsumi i karburantit dhe vajit për secilin mjet, aktivitetet e mirëmbajtjes dhe data;

Numri dhe itineraret e mjeteve;

Lista e rrugëve të fshira manualisht dhe mekanikisht, orët ditore të fshirjes manuale dhe mekanike të rrugëve;

Lista e punëtorëve dhe orët e punës;

Inventari mujor i kontenierëve, rrugë pas rrugë, me numrin e ID dhe gjendjen;

Zhvendosja e kontenierëve sipas planit të miratuar, mirëmbajtja ose humbja e kontenierëve, kontenierët e larë: lista e këtyre kontenierëve (rruga, numri i ID), riparime specifike, data;

Të gjitha të dhënat do të mblidhen dhe ruhen në kujdesin e përgjegjesit të sektorit të pastrimit-gjelberimit dhe mund të supervizohen apo kërkohen nga bashkia me ritme periodike që përcaktohen më parë.

Në raportet mujore, sektori i pastrimit-gjelberimit propozon modifikime tek drejtori:

Propozon për të shtuar numër kontenierësh nëse është e nevojshme

Propozon për të reduktuar numër kontenierësh kur është e nevojshme ose zhvendosjen e tyre

Propozon të shtojë pika të reja për grumbullimin e mbetjeve

Propozon të gjitha mundësitë për përmirësimin e shërbimit, rikuperimin e mbetjeve, etj.

Neni 27

GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR I MU

Largimi publik i MU organizohet në mënyrë të tillë që fillimisht të mbulojë gjithë territorin e bashkisë e më pas të arrijë sa më tepër të jetë e mundur objektivin e reduktimit të prodhimit të MU si dhe të ndarjes në burim të tyre.

Bashkia synon të organizojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve sektorit të pastrim-gjelberimit apo edhe përmes partneritetit me kompanitë private për fraksione të vecanta të mbetjeve të riciklueshme të thata dhe përmes projekteve pilot në shkollë, tregje dhe qendra tregëtare, apo edhe në zonë të vecanta të qytetit me aktivitete të ndryshme ekonomike.

Mbetjet e riciklueshme të thata përfshijnë letrën, kartonin, qelqin plastikë, kanaçet metalike, veshjet, si dhe materiale të tjera të konsideruara si të rikuperueshme. Për këto lloje mbetjesh mund të përcaktohen mënyra grumbullimi të ndryshme:

- Nëpërmjet zbatimit të principit 'Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit', sipas të cilit çdo prodhues, importues ose tregëtar është përgjegjës për të gjitha produktet që ai tregëton në momentin që ato kthehen në mbeturinë. Këta prodhues duhet të organizojnë, financojnë ose të jenë pjesë e skemave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve që ata prodhojnë. Tipikisht këto skema përfshijnë mbetjet e paketimit, mbetjet elektrike elektronike, bateritë, mbetjet nga ndertim shkaterimi, vajrat e përdorur etj.

- Nëpërmjet vendosjes së kontenerëve të vecantë sipas rrymave specifike (karton/leter/qelq/plastik/alumin etj) në PGM që konfigurohen si ishuj ekologjik. Prodhuesit e mbetjeve duhet të çojnë në këto PGM vetëm ato fraksione të MNU për të cilat ofrohet shërbimi i grumbullimit të diferencuar. Transporti i tyre drejt pikave të rikuperimit të materialeve duhet të kryhet nga operatorët e shërbimit që operojnë në atë zonë sipas një kalendari (me orarë dhe frekuencë të miratuara nga bashkia)

Për përdoruesit që prodhojnë sasi të mëdha të këtyre mbetjeve si shkollë, institucione shërbimi, tregje ose aktivitete ekonomike ose të ngjashme mund të organizohet një shërbim grumbullimi i diferencuar vetëm për rrymat specifike që ato prodhojnë me kontenerë të përshtatshëm për objekte apo godina specifike. Bashkia ve në dispozicion konteniere dhe PGM ndërsa transporti mund të financohet nga bizneset të cilave u ofrohet ky shërbim i dedikuar ose në rastin e institucioneve publike nga operatorët e shërbimit.

Grumbullimi i miksuar i fraksioneve të riciklueshme të thata (leter/karton/ambalazh/plastike/alumin) ose i fraksioneve të riciklueshme të njoma (mbetjet e kompostueshme/mbetjet e kopshteve) në një kontener të vecantë për t'u ndarë më pas në mënyrë mekanike gjatë fazave të tjera të rikuperimit.

Për të mundur shërbimin e grumbullimit të diferencuar, do të behen publike ndaj prodhuesve të mbetjeve, vendndodhja e kontenerëve dhe qëndrave të grumbullimit/ishujve ekologjik si dhe mënyrat e ndryshme të kryerjes së shërbimeve.

Prodhuesi i mbetjes në mënyrë të detyrueshme duhet të dorëzojë në mënyrë të ndarë të gjithë mbetjet urbane për të cilat është përcaktuar kryerja e shërbimit të grumbullimit të diferencuar.

Bashkia përcakton:

Mënyrat e dorëzimit nga prodhuesi i mbetjeve dhe fraksioneve për t'u grumbulluar;

Mënyrat dhe frekuencat e grumbullimit me fraksionet e ndryshme;

Mënyrat e menaxhimit të infrastrukturës grumbulluese (kontenieryt dhe transportin) për prodhuesit e mbetjeve sipas tipologjive të veçanta.

Kompanitë që kryejnë shërbimin e grumbullimit të diferencuar mbajnë shënim sasi të mbetjeve të diferencuara dhe raportojnë për këto mbetje periodikisht në përputhje me Nenin 26 të kësaj rregulloreje.

Neni 28

FORMA E REALIZIMIT TË SHËRBIMIT

Realizimi i shërbimit të mbledhjes, largimit e trajtimit të mbetjeve (MGU) dhe pastimit të qytetit realizohet:

1. Nga sektori publik i pastrim-gjelberimit në Bashki.

2. Nga operatore kompani/te private.

Në rast se shërbimi realizohet sipas pikes 2, të gjitha procedurat për hartimin e procedurës standarte të veprimit (PSV) miratohen me vendim të Keshillit Bashkiak.

IV. ROLI I BIZNESEVE DHE KOMUNITETIT NË MENAXHIMIN E MU

Neni 29

PASTRIMI I TERRITOREVE

Te gjitha hapësirat dhe territoret private pastrohen nga vetë pronarët e tyre.

Te gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatorë, detyrohen të mbajnë pastër territorin përreth lokalit apo vendit të punës në nje rreze veprimi 5m.

Hapësirat private te cdo lloj aktiviteti duhet te pastrohen çdo ditë pas përfundimit të aktiviteteve nga përdoruesit e tyre.

Nëse personat juridik apo fizik që janë përdorues të territoreve private nuk kryen aktivitetet e pastrimit apo bëhet shkak për ndotje të territorit, bashkia ka të drejtë të njoftojë dhe më pas të sanksionojë kundravajtësin.

Te gjitha hapësirat e tjera publike që nuk janë të përfshira në skemën e pastrimit të qytetit pastrohen nga përdoruesit e këtyre hapësirave (banorët ose institucionet).

Neni 30

NDOTJA E HAPESIRAVE PUBLIKE

Ndalohet hedhja dhe derdhja e mbeturinave dhe ujrave që dalin nga pastrimi ose larja e lokaleve të shërbimit në trotuare, rrugë e sheshe të qendrave të banuara.

Cfaredolloj grupimi qytetaresh që ka për qëllim organizimin e nismave si: festa, panairë, festime popullore, vrapime, spektakle lëvizëse ose manifestime edhe të llojit kulturor apo sportive, etj, në rrugë, sheshe dhe hapësira publike apo për përdorim publik, janë të detyruar të sigurojnë direkt, ose nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me sektorin e shërbimit, mbajtjen pastër të hapësirave, që i janë dhënë atyre për përdorim, si gjatë ashtu edhe në fund të nismës.

Të gjitha mbetjet e prodhuara direkt nga aktiviteti i tyre ashtu edhe ato të prodhuara nga frekuentimi i aktiviteteve prej qytetarëve duhen dorëzuar në kontenierë te përshtatshëm të vendosur për këtë qëllim nga administratori kur merret leje per zhvillimin e ketyre aktiviteteve.

Të gjitha detyrimet e tjera suplementare të dala nga kryerja e pastrimit, do ti ngarkohen organizuesve te ketyre aktiviteteve.

Neni 31

DOREZIMI I MBETJEVE URBANE

Sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve urbane nga familjarët dhe nga të gjithë subjektet e tjerë, bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbetjeve urbane që ka caktuar administratori i shërbimit ose me kontenierë individualë që përcaktohen sipas llojit të prodhuesit, sasisë së mbetjeve dhe infrastrukturës. Dorëzimi i tyre jashtë rregullave të përcaktuara nga Bashkia, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Mbetjet urbane nga familjarët e bizneset ne sezonin veror (Qershor- Gusht) duhet te dorezohen ne konteniere ne dy orare

- Nga ora 15³⁰ - 16³⁰ dhe nga ora 22⁰⁰ – 24⁰⁰. Dorezimi jashte ketij orari do te konsiderohet shkelje.

- Mbetjet urbane nga familjarët e bizneset ne periudhen jashte sezonit veror duhet te dorezohen ne konteniere nga ora 20⁰⁰ – 22⁰⁰. Dorezimi jashte ketij orari do te konsiderohet shkelje.

Tregtarët dhe persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosha të posaçëm për grumbullimin e mbetjeve urbane që krijohen gjatë tregëtimit dhe shërbimit që ata i ofrojnë qytetarëve.

Mbetjet e vëllimshme (si automjete, makineri, karrige, tavolina, kolltuqe), mbeturina ndërtimore (llaç,tulla,beton,dhera) çohen nga pronarët në vendin e posaçëm për depozitimin dhe përpunimin e tyre. Braktisja e tyre jashtë vendeve të përcaktuara, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët, farmacitë, klinikat stomatologjike shtetërore ose private, detyrohen të përdorin konteniere të posaçëm për mbeturinat e rrezikshme spitalore, të cilat i nënshtrohen një trajtimi të veçantë. Keto mbetje duhet të mblidhen në mënyrë të diferencuar nga mbetjet e tjera urbane. Grumbullimi i tyre në mënyrë të miksuar me mbetjet e tjera urbane përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Kopshtet shkollat apo edhe institucionet e tjera publike a private, mund të përdorin sistemin e diferencuar të grumbullimit me disa kosha për të nxitur informimin dhe edukimin. Në të gjitha rastet nëse nuk ofrohet nga administrator i shërbimit, keto institucione duhet të sigurojnë transportin e mbetjeve në vendin e posaçëm për depozitimin dhe përpunimin e tyre.

Neni 32

KUFIZIMET PËR GRUMBULLIMIN E MU

Bazuar në përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane është detyrim i prodhuesit të tyre. Ai duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orareve të përcaktuara nga Bashkia si dhe mbështetur në kategorizimin e mbetjeve dhe prodhuesve të përcaktuar në këtë rregullore.

Grumbullimi dhe dorëzimi i mbetjeve që nuk konsiderohen si mbetje të ngurta urbane nga kuadri ligjor i fushës dhe nga kjo rregullore, do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Bashkia për këtë qëllim.

Gjatë procesit të ndërtimit, rikonstruksionit apo prishjes së objekteve, qytetarët investitorët dhe subjektet ndërtues, marrin masa për grumbullimin e diferencuar dhe largimin e vazhdueshëm të mbeturinave ndërtimore.

Hedhja e mbetjeve ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia për mbetjet e ngurta urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Neni 33

GRUMBULLIMI I MBETJEVE VOLUMINOZE DHE INERTE

Është përgjegjësia e gjeneruesit (familjare, biznese apo industri) që të transferojnë mbetjet e prodhuara tek vendet e përcaktuara nga bashkia.

Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e një vend-depozimit për mbetjet voluminoze dhe inerte. Kapaciteti ditor i depozitimit nuk duhet të kalojë vlerë 10 ton.

Skatori përgjegjës për menaxhimin e vend-depozitimit ka për detyrë të raportojë tek Bashkia Permet dhe Agjensia Rajonale e Mjedisit mbi sasinë e gjeneuara.

Neni 34

SHERBIMI I PASTRIMIT NË TREGJE

Administratorët e tregjeve, persona të veçantë apo grup personash tregtare që marrin me qera vendet e shitjes në tregjet private apo publike, të organizuar në hapësirat publike ose private, duhet të administrojnë vetë pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Për sa i përket administrimit të mbetjeve që dalin këto tregje duhet të operohet si më poshtë vijon:

Administratori i tregut privat apo përfaqësuesi i tregtarëve është përgjegjës për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve për në fushën e depozitimit duke lidhur detyrimisht kontrata të veçanta me bashkinë ose operatorë privat të shërbimit të licensuar, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjieno sanitare të kësaj rregulloreje.

Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga Bashkia pikat e grumbullimit të mbetjeve të përkoheshme ose të përhershme, brenda territorit, për të mundësuar vendosjen e kontenerëve.

Të gjithë shitësat e tregjeve, mbetjet urbane që krijojnë gjatë tregetimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë të palosura apo sistemuara ose të mbyllura në qese, dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbetjeve konsiderohet shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

V. TARIFA PËR MENAXHIMIN E MU

Neni 35 HARTIMI I TARIFAVE

Hartimi i tarifave të pastrimit bazohet në parimet kryesore si: (i) rikuperimi i kostos, e cila përfshin koston e operimit dhe mirëmbajtjes, kostot administrative dhe të amortizimit, (ii) ndotesi paguan, gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë për eliminimin e saj në mënyrë sa më proporcionale, (iii) barazia, prodhues të ngjashëm të mbetjeve duhet të paguajnë mundësisht tarifa të ngjashme.

Tarifa e pastrimit hartohet në përputhje me vendimin Nr.319, datë 31.05.2018 “për miratimin e masave për kostot e manaxhimit të integruar të mbetjeve” sipas udhëzuesit “modelet për llogaritjen e tarifave për menaxhimin e mbetjeve” Tarifat duhet të reflektojnë kostot dhe qytetarët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente për kostot dhe llogaritjen e tarifave.

Sipas kategorive të gjenerimit të mbetjeve shtëpiake, tarifa do të përcaktohet në ndryshme për tri grupet kryesore/klientët, si më poshtë: (i). Familjare/familjet; (ii). Publike/institucionale; dhe (iii) Private/bizneset.

Çdo familje, institucion apo biznes përfaqëson një njësi, të cilit do t’i lëshohet një faturë.

Bashkia mund të aplikojë tarifa të ndryshme edhe brenda të njëjtit grup/klienti duke u bazuar në shërbimin që përfitojnë si dhe në sasi dhe lloji të mbetjeve që gjenerojnë. Mund të aplikohen gjithashtu pagesa shtesë mbi tarifën për biznese të veçantë ku lloji dhe sasia e mbetjeve që prodhojnë, nuk mund të përballohet nga shërbimi i largimit publik i mbledhjes së mbetjeve.

Bashkia mund të aplikojë zbritje të tarifës nëse bizneset marrin vetë përsipër largimin e mbetjeve. Në këtë rast mund të aplikohet vetëm tarifa për depozitimin e mbetjeve në fushat e trajtimit të tyre.

Për çdo ndryshim të masës së tarifave shpallet një veprim ndryshimi. Afati i tarifës së re përcaktohet në vendimin e ndryshimit. Mbipagesat trashëgohen.

Niveli i tarifës, përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.

Neni 36 MBLEDHJA E TARIFAVE

Tarifa e pastrimit mbledhet nga autoritetet e bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të mbledhjes, largimit e trajtimit të mbetjeve dhe pastimit e qytetit.

Autoritetet e bashkisë mund të ngarkojnë një palë të tretë, për përlogaritjen e tarifave, hartimin dhe dëgjimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre, lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e bashkisë, përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni nga kjo palë e tretë, të autoriteteve.

Vendosja e tarifës së pastrimit pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit të këshillit bashkiak për tarifën e pastrimit. Paketa fiskale.

VI. INFORMIMI I PUBLIKUT PËR MENAXHIMIN E MU

Neni 37 DETYRIMI PËR INFORMIM

Bashkia harton planin lokal të menaxhimit të mbetjeve urbane përmes një procesi me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të interesit përfshirë edhe publikun.

Bashkia zgjedh opsionin më të mirë praktik, me kosto më të ulët, më të pranueshëm nga pikëpamja sociale dhe në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane pas konsultimit me grupet e interesit përfshirë edhe publikun.

Në procesin e vendim-marrjes për përcaktimin e tarifave për çdo opsion të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane ftohen të marrin pjesë të gjitha grupet e interesit përfshirë edhe publiku i interesuar.

Në procesin e vendimmarrjes për përcaktimin e vendeve të impinteve të trajtimit dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë të gjitha grupet e interesit përfshirë edhe OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.

Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurin e procesit të largimit publik të mbeturinave, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.

Personat fizik e juridik që janë angazhuar në largimin publik të mbetjeve, që kanë dhe përdorin impiante të trajtimit të mbetjeve, duhet të publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre jo më rrallë se një herë në tre muaj.

Neni 38

FUSHATAT E INFORMIMIT DHE TE SENSIBILIZIMIT

Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzimin dhe largimin publik të mbeturinave.

Bashkia dhe sektori i pastrim-gjelberimit kujdeset për fushatat e nevojshme të informimit, edukimit dhe sensibilizimit për të stimuluar bashkëpunimin me biznesin dhe komunitetin.

Duhet të promovohen nga drejtoritë përkatëse në bashki sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë në fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin mbi:

Ndarjen e mbetjeve sipas fraksioneve të riciklueshme dhe të kompostueshme për të cilat është aktivizuar shërbimi i grumbullimit të diferencuar;

Qëllimin dhe mënyrat e kryerjes së shërbimeve;

Destinacionet e fraksioneve që rikuperohen;

Detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve;

Në mënyrë të veçantë fushatat e informimit dhe sensibilizimit mund të realizohen;

Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushatave ndërgjegjësuese, broshura, postera apo stenda për në ambientet e bashkisë, shkollave apo zonave të ndryshme të qytetit ku pilotohen nismat për grumbullimin e diferencuar/riciklimin/kompostimin;

Përgatitja e spoteve publicitare informuese për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik;

Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të bashkisë dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale;

Përfshirja e ekspertëve/trajnuarëve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkolla dhe në komunitet;

Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin;

Neni 39

OPINIONI I QYTETAREVE

Bashkia duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacionit për të marrë ankesat. Numri i ankesavete marra dhe të zgjidhura brenda një muaji është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Bashkia duhet të masë kënaqësinë e publikut për cilësinë e shërbimit të pastrimit përmes sodazheve me pyetësorë, të paktën 1 herë nëdy vjet.

Neni 40

BASHKEPUNIMI ME ORGANIZATA JO FITIMPRURESE

Në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane, bashkia mund të bashkëpunojë me shoqatat vullnetare, OJF-te, apo grupime të tjera të interesit me pjesëmarrës nga publiku etj.

Organizatat jo fitimprurëse kryejnë kontribute të nevojshme, me qëllim sensibilizimin e komunitetit, ndihmën në grumbullimin në mënyrë e duhur të mbetjeve ose pastrimin e qytetit, të frymëzuar nga qëllime mjedisore, pa qëllime përfitimi duke përdorur aktivitete vullnetarizmi apo projekte;

Organizatat jo fitimprurëse mund të përfshihen edhe në grumbullimin e pjesëve specifike të mbetjeve urbane të riklueshme, pas nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkinë, me paraqitjen e kërkesave të nevojshme që tregojnë mënyrat e kryerjes së grumbullimit, llojet e materialeve që grumbullohen dhe destinacioni i tyre, për më tepër edhe mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit me qëllim garantimin e higjenës dhe sigurisë së punës që do të kryhet. Aktiviteti i organizatave jo qeveritare autorizohen nga Bashkia, e cila përcakton vendin dhe mënyrat dhe rregullat e ndëryhrjes etj.

VII. NDALIMET DHE KONTROLLI

Neni 41

NDALIME DHE DETYRIME

Shkeljet ndaj rregullores përbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Përveç ndalimeve të shprehura qartë në nenet e rregullores është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, e çdo lloj mbetje e ngurtë, gjysëm e ngurtë, e lengët e çdo lloji natyre dhe dimensionit edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi edhe për sipërfaqet ujore, lumenjtë, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet anët e rrugëve etj.

Gjithashtu është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve urbane në vendet e zbuluara të hapësirave private. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave. Cilido që shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryejë largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar.

Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve inerte/të vëllishme në pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, veprim që mund t'i shkaktojë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit apo personave përgjegjës për shërbimin

Është e ndaluar për qytetarët dhe për këdo person të paautorizuar të kryejë çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, kërkimi apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final.

Është e ndaluar hedhja në kontenierë e mbetje të lëngta, e substancave ndezëse, e mbetjeve spitalore, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik.

Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi, etj si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në këtë rregullore, në kontenierët publik apo në pikat e grumbullimit të mbetjeve.

Është e detyrueshme për të gjithë prodhuesit dhe mbajtësit e mbetjeve urbane nëse këto të fundit janë objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rikuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto mbetje në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respective.

Është e ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajiseve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo përmbyjsja e tyre.

Janë ndaluar sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes.

Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare kuti, shishe dhe të ngjashme).

Është e ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit i kafshëve të ngordhura si dhe i mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme.

Djegia e mbetjeve urbane në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymërat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.

Ndalohet prezenca dhe kullotja e kafshëve shtëpiake dhe barngrënëse në mbetjet urbane të kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbetjeve të ushqimeve për kafshët si mbetje buke, etj.

Ndalohet hedhja në kontenieret publik apo në pikat e grumbullimit, mbetjet e gjelbra të prodhuara nga krasitjet e pemeve, barit apo punimet në kopshte dhe oborre, apo e mbetjeve të tjera me origjinë bujqesore sezonale.

Nuk pranohet e drejta për të kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm i ofruar për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave pa miratimin e Bashkisë.

Neni 42 KONTROLLI

Përveç kompetencave të organizmave përgjegjëse me ligj për kontroll, Bashkia aktivizon mbikëqyrjen për të respektuar rregulloren duke aplikuar sanksione administrative të parashikuara në të.

Autoritetet e caktuara për kontroll janë të autorizuar të kryejnë të gjitha inspektimet që mendojnë të nevojshme, për të vërtetuar respektimin e normave të caktuara në rregullore.

Bashkia ka të drejtën të kërkojë nga prodhuesit e mbetjeve speciale të paraqesin dokumentacionin vërtetues të prodhimit apo përpunimit që kryhet.

Në rastet e vërtetimit për mosrespektim të rregullores, Bashkia nëpërmjet një akti të motivuar nga arsye sanitare, higjienike dhe mjedisore, vendos kryerjen e punimeve të nevojshme, barrë kjo në ngarkim të subjektit përgjegjës për ndotje. Gjithashtu urdhëron adaptimin e masave oportune për të parandaluar përsëritje të mosrespektimit të rregullores, si dhe marrjen e masave penalizuese sipas normave në fuqi.

Në rastet e lënies së mbetjeve në hapësirat publike ose për përdorim publik, ku nuk është identifikuar subjekti përgjegjës për ndotje, Bashkia kryen me shpenzimet veti grumbullimin e mbetjeve dhe përpunimin e mëtejshëm.

VIII. SANKSIONET PËR SHKELJEN E RREGULLORES

Neni 43 SANKSIONET

Shkeljet të dispozitave të kësaj Rregulloreje, përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara si më poshtë vijon:

Sanksionet për kundravajtjet administrative, të parashikuara më sipër, ekzekutohen brenda 5 ditëve. Ankimimi për to bëhet në përputhje me Ligjin Nr.7697, datë 07.04.1993 “Për Kundravajtjet Administrative” i ndryshuar.

Referuar	Shkelja	Sanksioni Administrativ
Neni 16, paragrafi 69	Dorëzimi i mbetjeve urbane jashtë kontenierëve.	Persona fizike: 2.000 lekë/m ² Persona juridike: 5.000 lekë/m ²
Neni 16, paragrafi 75	Dorëzimi ditor i mbetjeve urbane në një volum më të madhë se 1/4 e volumit të një kontenieri publik	5.000 lekë Në mënyrë të përsëritur: 10.000 lekë
Neni 21, Paragrafi 95	Ndotja me dhe e baltë e rrugëve dhe trotuareve gjatë transportit ose punimeve në kantierët e ndërtimit	10.000 lekë/m ² 50.000 lekë/m ² (në mënyrë të përsëritur)

Neni 24, paragrafi 110	Dorëzimi(hedhja) mbetjeve, apo mbetjeve nga shërbimi i pastrimit, në pusetat e elektrikut, ujësjllësit, basnet ujore, etj.	10.000 lekë
Neni 29,paragrafi 132 Neni 41,paragrafi 182	Mos kryerja e pastrimit -të territorit apo vendit të punës mbas mbarimit të aktivitetit , për tregjet apo tregtarët ambulant; -para lokaleve apo vendit të punës në gjerësi 2-5m	5.000 lekë/m ²
Neni 30, paragrafi 134	Hedhja ,derdhja në trotuare e ujrave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit , dyqaneve etj.	5.000lekë/m ²
Neni 32,paragrafi 143	Ekspozimi i qeseve me mbetje përgjatë rrugëve në ditë dhe orare të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Bashkia	Persona fizikë: 2.000lekë Persona juridikë: 5.000 lekë
Neni 34,paragrafi 151	Dorëzimi i pasistemuar, i paplotësuar, apo i pambyllur i mbetjeve tregtare, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia	5.000 lekë/m ²
Neni 35,paragrafi 120	Mos kryerja e pastrimit , apo lejimi i ndotjes të territoreve private të zbuluara.	5.000 lekë/m ²
Neni 41, Paragrafi 181, 182	Shkarkimi, depozitimi i mbetjeve nga makinat e madhësive të ndryshme në territore publike brenda territorit të Bashkisë	100.000lekë/m ²
Neni 41, paragrafi 184	Dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme,mbetjeve të ndërtimit apo kontenierëve apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane.	Persona fizikë : 5.000lekë/m ² Persona juridikë:10.000lekë/m ²
Neni 41,paragrafi 185	Kryerja e selektimit manual , kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë , etj nga persona të pa autorizuar	5.000 lekë
Neni 41, paragrafi 186	Dorëzimi në kontenierë apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve , i mbetjeve të lëngëta e substancave ndezëse, e mbetjeve spitalore, apo kafshëve të ngordhurapër më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik.	Persona fizike: 5.000 lekë Persona Juridike: 10.000lekë
Neni 41,paragrafi 187	Dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi , përpunimi,trajtimi etj si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në rregullore, në kontenierët publik apo në PGM	5.000 lekë/m ² Në mënyrë të përsëritur: 10.000lekë/m ²
Neni 41,paragrafi 189 Neni 18,paragrafi 82	Ndryshimi abuziv iPGM-eve apo konteniereve, të përcaktuara nga Bashkia	5.000 lekë Në menyre të përsëritur: 10.000 lekë
Neni 41,paragrafi 189	Dëmtimi i pjesshëm apo total i kontenierit – Vjedhja e kontenierit	10.000 – 30.000 lekë
Neni 41,paragrafi 190	Parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të grumbullimit të mbetjeve ose në hapësirat e manovrimit të mjeteve të pastrimit	5.000 lekë
Neni 41, Paragrafi 194	Djegia e mbetjeve urbane në kontenierë, në PGM,në territore private dhe publike brenda territorit të Bashkisë	Persona fizikë:10.000lekë Persona juridik dhe operatorët e shërbimit: 100.000lekë
Neni 41,paragrafi 195	Hedhja e mbetjeve të krasitjeve te pemeve, mbetjet nga punimet ne kopshtari, korrja e barit etj	Persona fizike: 2.000lekë Persona Juridike:5.000lekë

BASHKIA PERMET